



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE  
BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 184, datë 27.10.2023**

**PËR  
NJË NDRYSHIM NË ANEKSIN E LICENCËS NR. 3, DATË 29.12.2021  
TË SHOQËRISË “BANKA OTP ALBANIA” SH.A.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të ligjit nr. 9572 datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, nenit 21 dhe nenit 43 pika 2, të ligjit nr. 62/2020 “Për Tregjet e Kapitalit”, si dhe të rregullores nr. 195, datë 29.12.2020 “Për licencimin e shoqërisë komisionere, regjistrimin e degës së shoqërisë së huaj komisionere dhe njohjen e shoqërisë së huaj komisionere”, e ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I :**

1. Në Aneksin e licencës nr. 3, datë 29.12.2021, të shoqërisë “Banka OTP Albania” sh.a., fjalia:  
*“Duke përjashtuar titujt e transferueshëm dhe instrumentet e tregut të parasë, të cilat përmbajnë në strukturën e tyre një instrument derivativ, apo që konsiderohen instrumente komplekse”* shfuqizohet, sipas formatit bashkëlidhur.
2. Ngarkohet Drejtoria e Mbikëqyrjes së Tregut të Titujve, për njoftimin në zbatim të këtij vendimi.

**Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**

**KRYETAR  
Olsi ÇOKU**

**NËNDREJTOR EKZEKUTIV  
Mimoza KAÇI**